



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:132032

Datë: 19.10.2023

Numri i dokumentit: 04803814

PPP.nr.1510/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtoren profesionale Fatmire Haziri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores L.B nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës SHSKUK – QKUK, me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit P.nr.944/20, të datës 28.05.2020, të lejuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Afet Mjeku në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET i bazuar prapësimi i përfaqësuesit të autorizuar të debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës SHSKUK – QKUK, me seli në Prishtinë.

II. SHFUQIZOHET Urdhri për lejimin e Përmbartimit P.nr.944/20, i datës 28.05.2020, i lëshuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Afet Mjeku në Prishtinë, si dhe REFUZHET i pabazuar propozimi për përmbartim i parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Afet Mjeku në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të parashtruar nga e autorizuari i kreditores L.B, nga Prishtina, ka lejuar përmbartimin në bazë të Urdhrit Përmbartimor P.nr 944/20, i datës 28.05.2020, në bazë të dokumentit përmbartimor – vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020, me të cilin Urdhër është detyruar debitori që t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 529.65 euro, shpenzimet për avokatin në shumën prej 156.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër këtij Urdhëri Përmbarrimor, brenda afatit të paraparë ligjor prapësim ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuari i debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë. Në prapësim, ndër tjera theksohet se në Urdhërin për Përmbarrim është konstatuar në mënyrë të gabuar gjendja faktike, ndërsa në vendimin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi nuk është caktuar shuma e mjeteve monetare të cilat debitori duhet t'ia paguajë kreditorit. Më tutje pretendohet se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe se i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbarrim ashtu siç kërkohet me nenin 27 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore dhe në këtë kuptim Urdhëri Përmbarrimor është lëshuar në kundërshtim me nenin 71 dhe 73.3 të LPP-së. Po ashtu, pretendohet se propozimi për përmbarrim është paraqitur në kundërshtim me nenin 144 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili parasheh që akti administrativ ekzekutohet kur hynë në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vetë organi administrativ i cili e ka nxjerrë këtë vendim, ndërsa vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi nuk është bërë ende i ekzekutueshëm sepse sipas këshillës juridike pala e pakënaqur ka pas të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, të drejtë të cilën debitori e ka shfrytëzuar pranë organit të shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës dhe ende nuk ka pranuar përgjigje lidhur me këtë ankesë. Gjithashtu nuk mund të ekzekutohet akti administrativ kundër të cilit është bere ankesa dhe ndaj të cilit nuk është paraparë klauzola. Po ashtu Propozimi për Përmbarrim është bere edhe në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 i LPP-së, ku theksohet se procedua përmbarrimore fillohet me propozimin e kreditorit e në këtë propozim autorizimin për fillimin e procedurës nuk është dhënë nga kreditori por nga një pale tjetër e i cili autorizim nuk është i ligjshëm sepse askush nuk mund të angazhoj përfaqësues me prokurë në emër të personit tjetër pa autorizim pasi që autorizimi i Sindikatës FSSHK në procedurë gjyqësore nuk do të thotë leje e kreditorit. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhëri për Përmbarrim.

Përmes përgjigjes në prapësim, i autorizuari i kreditorit i ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuara pretendimet e debitorit të dhëna në prapësim nuk përmbajnë asnjë nga kushtet sipas nenit 71 të LPP-së. Debitori pa bazë thekson se vendimi i Inspektoratit nuk është titull përmbarrimor me arsyetim se urdhri për përmbarrim është nxjerrë në kuptim të nenit 22 par.1 nën par.1.2 të LPP-së dhe i njëjti përmban dy vulat atë të përmbarrueshmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Sa i përket shumës së Inspektoratit të Punës me vendimin e saj e ka obliguar debitorin që të bëjë pagesën e pagave jubilarë në bazë të pagës mujore të kreditorit dhe shuma është bazuar në listën e pagave. Po ashtu, thekson se vendimi i nxjerrë në procedurë administrative është dorëzuar në origjinal tek organi përmbarrues, fakt ky që vërtetohet edhe nga shkresat e lëndës. Ndërsa sa i përket autorizimit, avokati i cili e përfaqëson e ka këtë autorizim nga sindikata e kreditorit, duke u mbështetur në Ligjin për Organizimin Sindikal i Kosovës me Nr.04/-L-011 përkatësisht nenin 2.1.2 I cili thekson se “Organizata sindikale – çdo organizatë e të punësuarve e krijuar në formë të shoqatës apo njësisë organizative të federatës, konfederatës, e cila ka për qëllim të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e punëtorëve të bashkuar në organizatë sindikale”, po ashtu sipas nenit 15 të të njëjtit ligj, parashihen të drejtat e Sindikatës pas regjistrimit, andaj pasi që sindikata është person juridik, ka të drejtë të bartë autorizime tek personat e tretë. Bazuar në këto pretendime, ka vlerësuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar në nenin 69 par.5 dhe nenin 71 të LPP-së, andaj ka propozuar që i njëjti të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbarrimor.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbarimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbarim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe mungesa e njërit prej tyre në dokumentin përmbarimor, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbarim.

Në rastin konkret, propozimi për përmbarim është paraqitur duke u mbështetur në Vendimin e Inspektoratit të Punës, 01Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020. Në bazë të shqyrtimit të këtij vendimi, Gjykata gjen se në dispozitiv të të njëjtit është aprovuar si e bazuar ankesa e kreditorës L.B dhe është obliguar debitori që në afat prej 8 ditësh të bëjë kompensimin e një 1(një) pagë mujore në emër të shpërblimit jubilar. Megjithatë, këtij Vendimi i mungon shuma e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit si një nga elementet që duhet t'i përmbajë dokumenti përmbarimor për të qenë i përshtatshëm për përmbarim.

Në prezencën e rrethanave të tilla, Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi në këtë çështje juridike nuk i përmbushë kushtet për të qenë i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës nga neni 27 par.1 lidhur me nenin 24 të LPP-së.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh faktin se në shkresat e lëndës, përveç vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi janë të bashkangjitura edhe prova tjera si lista e pagave për kreditorin, mirëpo Gjykata nënvizon faktin se meqë kemi të bëjmë me procedurë rigorozisht formale, me rastin e vendosjes lidhur me ligjshmërinë e lejitimit të përmbarimit, duhet kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit përmbarimor, që në rastin konkret është vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020.

Po ashtu, Gjykata mori parasysh faktin se shkresave të lëndës i është bashkangjitur edhe Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01/21-1178, i datës 18.11.2020 për korrigjimin e gabimeve në vendimin nr.01 nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, si dhe lista e punëtorëve në vendimin burimor me të dhënat e numrave personal si dhe vlerat e shumës për pagesë të punonjësve që janë të evidentuar në këtë vendim. Megjithatë, Gjykata nënvizon faktin se në çështjen konkrete, propozimi për përmbarim është mbështetur në vendimin Nr.01-Nr.21-1715-94, të datës 10.02.2020, mbi bazën e të cilin vendim edhe është lejuar përmbarimi dhe i cili vendim për arsyet e lartcekura nuk i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar i përshtatshëm për përmbarim. Në anën tjetër, fakti se është bërë korrigjimi i këtij vendimi përmes një vendimi të ri, nuk ka ndikim dhe relevancë në vlerësimin e përshtatshmërisë së vendimit i cili është objekt shqyrtimi dhe nuk paraqet bazë për vendosje ndryshe.

Bazuar në këto arsye, meqë Urdhëri Përmbarimor është lejuar mbi bazën e një dokumenti i cili nuk është i përshtatshëm për përmbarim, Gjykata konstatoi se prapësimi i ushtruar nga debitori gjen mbështetje në dispozitën e nenit 71 par.1 pika 1.1 të LPP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhërin për lejimin e Përmbarimit P.nr.944/20, të datës 28.05.2020, të lëshuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Afet Mjeku nga Prishtina, si dhe duke e refuzuar si të pabazuar propozimin për përmbarim të parashtruar nga përfaqësuesi e autorizuar e kreditorës L.B.

Nga arsyet e lartëcekura, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
PPP.nr.1510/20, datë 19.10.2023

Gj y q t a r i,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimet të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.